

Çmimet hava në Kosovë:
Pemët shtrenjtohen
16 %, rryma 15,5 %, mishi gati 14 %



RAPORTI ‘KOSTOJA E POLITIKËS NË KOSOVË’, MBI 12 MIJË EURO SHPENZIME PËR T’U BËRË DEPUTET



Democracy Plus (D+) dhe Westminster Foundation for Democracy (WFD) kanë publikuar raportin “Kostoja e politikës në Kosovë”, një studim që analizon shpenzimet e kandidatëve për deputetë gjatë zgjedhjeve nacionale të vitit 2025. Gjetjet kryesore të raportit tregojnë rritje të koston së fushatave, varësi të lartë nga

financimi personal dhe pabarazi mes burrave dhe grave në shpenzimet zgjedhore. Në bazë të raportit rezulton se mesatarja e shpenzimeve për një kandidat është 9 mijë e 463 euro, ndërsa kandidatët fitues shpenzojnë mesatarisht 12 mijë e 150 euro, kurse ata të pazgjedhur shpenzojnë 4 mijë e 90 euro

BEDRI HAMZA SHPALOS PROGRAMIN QEVERISËS PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT: BASHKË, PËRPARA F. 5



ÇFARË DUHET TË BËJË KOSOVA MË TEPËR PËR T’IU HEQUR MASAT E BE-së? F. 3



AKTUALE



TRUMPI PARAQET “VIZAT E ARTA” NË VLERË TË NJË MILION DOLLARËVE F. 2

ODA E AVOKATËVE ALARMON, DYSHON PËR PAJISJE TË DYSHIMTA INCIZIMI NË DISA OBJEKTE TË POLICISË SË KOSOVËS F. 6

ULUTASH: KOMUNIKIMET E RREGULLTA ME USHTRINË SERBE, VITALE PËR T’I PARANDALUAR PËRSHKALLËZIMET F. 5

EKONOMI



BANKA ZHVILLIMORE E KËSHILLIT TË EVROPËS VLERËSON PËRPARIMIN E BQK-së NË FORCIMIN E KORNIZËS MBIKËQYRËSE F. 8

PROJEKTI “SOLAR4KOSOVO I (100 MW)” HYN NË FAZËN E PARË TË TENDERIMIT F. 8

SPORT



FFK-ja SHPALL MË TË MIRËT E FUTBOLLIT MË 21 DHJETOR F. 11

RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**
GROUP SH.PK.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMPI PARAQET “VIZAT E ARTA” NË VLERË TË NJË MILION DOLLARËVE

UASHINGTON, 11 DHJETOR - Presidenti amerikan Donald Trump e ka paraqitur një skemë që mundëson sigurimin e vizës amerikane për periudhë afatgjatë për të pasurit që mund të paguajnë të paktën një milion dollarë. Trumpi ka thënë përmes postimeve në rrjete sociale se viza do t’u mundësojë blerësve të vizës “hyrjen direkte në rugën për shtetësi për të gjithë personat e kualifikuar dhe verifikuar”. “Sa emocionuese! Kompanitë tona të mrekullueshme amerikane më në fund do ta mbajnë talentin e tyre të çmuar”.



E ashtuquajtura Karta e Artë Trump është paraqitur për herë të parë më herët gjatë këtij viti, dhe atë mund ta blejnë ata që

lejes së qëndrimit në ShBA në “kohë rekord” dhe kushton një milion dollarë për të vërtetuar se një individ do të kontribuojë shumë për ShBA-në, sipas faqes zyrtare të programit. Bizneset që i sponsorojnë vizat për punëtorët e huaj duhet të paguajnë dy milionë dollarë, pa përfshirë tarifën shtesë. Një version tjetër i vizës që parasheh edhe kushte shumë të favorshme për taksa, është thënë se do të jetë i qasshëm shumë shpejt për pesë milionë dollarë. Tarifën shtesë qeveritare mund të ndryshojnë varësisht se kush aplikon, kanë bërë me dije

autoritetet. Kur Trumpi e ka paraqitur planin për herë të parë, ai i ka përshkruar vizat të ngjashme me ato ekzistuese në kuadër të programit të njohur si “karta e gjelbër”, e cila u mundëson imigrantëve me të ardhura të ndryshme që të jetojnë dhe punojnë përgjithmonë në Shtetet e Bashkuara. Poseduesit e këtij lloji të lejes së qëndrimit mund të aplikojnë për shtetësi pas pesë vjetësh. Mirëpo, Trumpi ka thënë se programi i ri është specifik për profesionistë “të nivelit të lartë”. “Ne duam njerëz që janë produktivë”, ka deklaruar ai.

KONFISKOHEN PESË MILIONË EURO NË OPERACIONIN KUNDËR “KARTELIT BALLKANIK” NË GJERMANI

BERLIN, 11 DHJETOR - Tre persona janë arrestuar dhe mbi pesë milionë euro janë konfiskuar në kuadër të një operacioni policor gjerman kundër një qelize të grupit të ashtuquajtur “Karteli Ballkanik”, ka bërë me dije Agjencia Evropiane e Policisë (EUROPOL) më 10 dhjetor. Shuma e parave besohet se është përfituar në kuadër të trafikimit të drogës nga Kolumbia. Në operacion janë përfshirë zyrtarë policorë nga Austria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe Serbia, bashkë me rreth 500 zyrtarë policorë gjermanë, të cilët kanë kryer bastisje kundër individëve të dyshuar për trafikim transnacional të drogës

dhe krim të organizuar. EUROPOL-i ka thënë se autoritetet e vendeve që janë përfshirë në operacion kanë kryer hetime dhe i kanë bllokuar llogaritë bankare dhe astetet e tjera në shtetet e lidhura me të dyshuarit, emrat e të cilëve nuk janë bërë me dije. “Shtetasit serbë B. B. (1963), B. I. (1976), M. B. (1999), M. N. (1997), S. S. (1987), R. M. (2004), D. P. (1993) dhe N. T. (1992) janë arrestuar në territorin e Spanjës. Ata dyshohet se janë anëtarë të grupit kriminal, përmes ofrimit të logjistikës dhe pajisjeve për pranimin e drogës së transportuar nga Kolumbia, e cila ka arritur me anije në Spanjë,



më pas është ruajtur dhe shpërndarë në koordinim me shumë grupe të tjera kriminale spanjolle”, ka njoftuar Ministria e Brendshme e Serbisë. Ministria ka bërë me dije se është ngritur një kallëzim penal si dhe është vendosur ndalesë ndaj shtetasit serb, Z. S., që të mos largohet nga Spanja. Masa e njëjtë e ndalesës vlen edhe për tre shtetas sllovenë dhe

një shtetas të Bullgarisë. Hetimi, sipas EUROPOL-it, ka shpërfaqur se kjo qelizë kriminale ishte përgjegjëse për dërgesat e kokainës së kontrabanduar nga Kolumbia për në Evropë. Rrjeti ka pastruar para përmes kompanive dhe ka blerë patundshmëri në shumë vende të BE-së dhe përtej. EUROPOL-i e ka përshkruar operacionin si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të shkatërruar grupe të krimit të organizuar që trafikojnë kokainë dhe droga të tjera në dhe rreth Evropës, duke përdorur rrjete komplekse të logjistikës. Kjo agjenci policore e Bashkimit

Evropian ka thënë se operacioni është kryer bazuar në informacionet e ndara dhe koordinimin e vendosur në hetimet e mëparshme ndërkufitare mbi rrjete për trafikim të drogës me origjinë nga Ballkani. Grupet e krimit të organizuar, të lidhura me Ballkanin, kanë qenë vazhdimisht në shënjestër të hetimeve shumëkombëshe, të koordinuara nga EUROPOL-i dhe partnerë tjerë në vjetët e fundit. Deri më tani në operacione janë zbuluar rrugë komplekse të trafikimit të njerëzve nga Amerika Jugore përmes Afrikës Perëndimore dhe Evropës.

BRUKSELI SHTON EMRA TË RINJ NË LISTËN E ZEZË NË PAKETËN E RE TË SANKSIONEVE KUNDËR RUSISË

BRUKSEL, 11 DHJETOR - Ambasadorët e Bashkimit Evropian morën vendim të mërkurën për sanksione shtesë kundër Rusisë, duke i shtuar disa individë dhe subjekte në paketën e re të listës së zezë, e cila u hartua si përgjigje kundër pushtimit të plotë të Ukrainës nga Kremli, pothuajse katër vjet më parë. Edhe pse kjo nuk është paketë e gjerë sanksionesh që përfshin masa kufizuese ndaj sektorëve kundër Moskës si në të kaluarën, blloku i ka përqendruar masat te pesë individë të përfshirë në biznesin global të naftës, me synimin për ta goditur Rusinë ndërsa ajo tregton nën kufirin e çmimit të naftës të vendosur nga vendet e G7-s, i cili aktualisht është 47.6 dollarë për fuçi. Në dokumentin zyrtar, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë, në listën e zezë është futur



biznesmeni azerbajxhanas Talat Safarov. Ai është shef ekzekutiv i 2Rivers Group, një kompani për tregtimin e naftës me bazë në Emiratet e Bashkuara Arabe, e cila, sipas Brukselit, është aktive në transportin dhe eksportin e naftës ruse, veçanërisht nga gjiganti shtetëror energjetik Rosneft, duke fshehur prejardhjen e vërtetë të naftës. Biznesmeni pakistanez Murtaza Ali Lakhani është gjithashtu cak i sanksioneve pasi konsiderohet se kontrollon “anije që transportojnë naftë të

papërpunuar ose produkte të naftës, me origjinë nga Rusia ose të eksportuara nga Rusia, duke përdorur praktika të parregullta dhe me rrezik të lartë në transport detar”. Këto praktika përfshijnë përdorimin e anijeve pa sigurim të rregullt dhe fikjen e pajisjeve të gjurmimit detar gjatë lundrimit. Tre individë rusë dhe katër kompani janë sanksionuar gjithashtu. Dy nga këto firma janë me bazë në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe besohet se kanë qenë të përfshira kohët e fundit në transportimin e naftës ruse. Një kompani me bazë në Vietnam dhe një tjetër në Rusi janë përfshirë për zotërimin ose menaxhimin e cisternave që janë pjesë e “flotës në hije” ruse. Ndërkohë, Brukseli pritet t’i fusë të premtën në listë 43 anije që beson se janë pjesë e flotës së

tanishme në hije. Lista, e cila ka mbi 500 anije, ua ndalon këtyre mjeteve të marrin çfarëdo shërbimi në portet e BE-së. Ambasadorët e BE-së u pajtuan gjithashtu t’i godasin personat që ata besojnë se kanë kryer aktivitete destabilizuese në emër të Rusisë në mbarë botën. Lista e përditësuar përfshin John Mark Dougan, një shtetas me shtetësi të dyfishtë amerikanoruse dhe ish-zëvendëssherif nga Florida, i cili u zhvendos në Rusi rreth një dekadë më parë. Ai akuzohet se ka marrë pjesë në operacione të informacionit digjital pro-Kremlinit nga Moska me qëllim “ndikimin në zgjedhje, diskreditimin e figurave politike dhe manipulimin e diskursit publik në vendet perëndimore”. Ish-koloneli i ushtrisë zvicerane, Jacques Baud, është gjithashtu në listë për veprimin “si

zëdhënës i propagandës proruse dhe përhapjen e teorive konspirative, për shembull, duke akuzuar Ukrainën se ka orkestruar vetë pushtimin e saj për t’u anëtarësuar në NATO”. Ish-oficeri francez i ushtrisë, Xavier Moreau, është përfshirë për veprime të ngjashme. Të tjerë të sanksionuar përfshijnë Dmitry Suslov, Fyodor Lukyanov dhe Andrei Sushentsov, të cilët përshkruhen si analistë të politikës së jashtme me lidhje të ngushta me klubin e diskutimit Valdai. Ata akuzohen për përhapjen e dezinformatave të lidhura me Kremlinin. Një numër zyrtarësh të Drejtorisë Kryesore të Inteligjencës së Rusisë (GRU) janë listuar dhe akuzohen për përgjegjësi në sulme të ndryshme kibernetike vitet e fundit kundër Ukrainës dhe shteteve anëtare të BE-së.

ÇFARË DUHET TË BËJË KOSOVA MË TEPËR PËR T'IU HEQUR MASAT E BE-SË?

Pavarësisht se në Kosovë pati një kalim paqësor të pushtetit në katër komunat veriore me shumicë serbe më 5 dhjetor, vendet anëtare të Bashkimit Evropian duket se nuk janë në të njëjtën linjë për t'ia hequr masat ndëshkuese. Që një kohë figura të rëndësishme shtetërore në Kosovë, nisur nga presidentja, e konsiderojnë vazhdimin e masave plotësisht të padrejtë. Por, a do të mund të bënte Kosova më shumë?



PRISHTINE, 11 DHJETOR - Kur Bashkimi Evropian (BE) vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës në verën e vitit 2023, si pasojë e tensioneve në veriu e banuar me shumicë serbe, ato u përshkruan si të përkohshme, ndërsa kushtet për heqjen e tyre qenë të qarta.

Zyrtarët në Kosovë ngulmojnë se kërkesat e BE-së për largimin e masave që e dëmtuan vendin në vlera milionëshe janë plotësuar: situata në veri është shtensionuar, prania e policisë afër objekteve komunale në veri është zvogëluar, serbët kanë marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura sivjet dhe kalimi paqësor i pushtetit në komunat me shumicë serbe është realizuar.

Por, ditët e fundit u raportua në mediet e Kosovës, bazuar në burime brenda BE-së, se vende si Franca dhe Italia, të mbështetura nga Spanja, Hungaria dhe Sllovakia, nuk

kanë vullnet për heqjen e sanksioneve.

Rikard Jozwiak, redaktor për Evropën i Radios Evropa e Lirë (REL), në Pragë, thotë se është e vërtetë që për çështjen e moslargimit të të gjitha masave kundër Kosovës është diskutuar në Bruksel këtë javë, dhe që Franca e Italia janë mbështetëse të idesë që të largohen vetëm 50 për qind e tyre. Sipas tij, Parisi insiston në këtë qëndrim meqë kërkon që Beogradi t'i hapë kapitujt për anëtarësim në BE, dhe është i zemëruar pse të tjerët po e bllokojnë procesin. “Ekziston edhe një argument i përgjithshëm se Brukseli nuk mund t'ia japë këtë ‘dhuratë’ [kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin] Kurti para zgjedhjeve të 28 dhjetorit. Nëse ky është një argument i vlefshëm apo jo, është vënë në pikëpyetje nga të tjerët, pasi partia kryesore e opozitës

[Partia Demokratike e Kosovës] i dërgoi një letër [shefes së BE-së, Ursula] Von der Leyen së voni, duke kërkuar heqjen e plotë [të masave] menjëherë. Pra, nuk perceptohet si dhuratë për Kurtin nga askush, përveç një numri të vogël shtetesh të BE-së”, thotë Jozwiak.

Një zëdhënëse e Bashkimit Evropian i tha REL-it se blloku evropian synon vazhdimin e heqjes së masave, proces që ka nisur pjesërisht në maj të këtij viti. Sipas saj, Brukseli është i gatshëm të punojë me autoritetet e Kosovës sapo të zgjidhen ato, dhe blloku pret nga Kosova të rikthehet në rrugën e reformave të nevojshme që lidhen me BE-në.

Por, për Qeverinë në detyrë të Kosovës zgjedhjet e parakohshme parlamentare nuk kanë asnjë lidhje me masat. “Çdo zvarritje tjetër vetëm sa e thellon

absurditetin e masave dhe e cenon kredibilitetin e BE-së. Qëndrimi ynë është që masat duhet të hiqen menjëherë dhe plotësisht”, thotë Klisman Kadiu, këshilltar për medie i zëvendëskryeministrit në detyrë, Besnik Bislimi, në disa përgjigje me shkrim për REL-in.

Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u shpreh, në një takim këtë javë me raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, se vazhdimi i masave ndëshkuese mbetet “i pashpjegueshëm, i padrejtë dhe i paarsyeshëm”. Terras, po ashtu, tha se masat duhen hequr menjëherë.

A mund të bënte Kosova më shumë?

Duke e përshkruar vazhdimin e masave të BE-së si

absurditet total, Besar Gërgi nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) thotë se Kosova ka humbur shumë kohë këtë vit në mungesë të institucioneve të reja dhe se do të mund të punonte më shumë për heqjen e masave.

Gërgi beson që formimi i institucioneve të reja është parakusht për heqjen e masave, ndërsa komunikimi me palët që hezitojnë duhet të jetë prioritet. Sipas tij, politika, sidomos në ditët e sotme, nuk bëhet në bazë të konsideratave morale, por bëhet vetëm për interesa politike. “Qeveria e re duhet të punojë aktivisht me aleatët. Gjatë këtij viti nuk ka pasur shumë komunikim. Fokusi ka qenë në krijimin e numrave, e ky ka krijuar ngecje në politikën e jashtme të Kosovës. Prandaj, nëse flasim për një qeveri funksionale, ky është minimumi jetik”, thotë ai për REL-in, duke përmendur edhe nevojën e miratimit të marrëveshjeve me BE-në, siç është Plani i Rritjes në momentin e parë të mundshëm. Sipas tij, koha është humbur edhe duke mos u marrë me aspektin teknik të integritetit evropian. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE më 2022, por kërkesa e saj nuk është shqyrtuar kurrë, duke e lënë vendin të vetmin në Ballkanin Perëndimor pa statusin e kandidatit për anëtarësim në bllok.

Gërgi beson se, përveç mungesës së komunikimit, në rritjen e shkallës së hezitimit te disa vende ka ndikuar edhe votimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kundër pjesëmarrjes së Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, në garën parlamentare.

Qeveria bullgare jep dorëheqje pas protestave masive

Sofje, 11 dhjetor - Kryeministri i Bullgarisë, Rosen Zhelyazkov, ka dhënë dorëheqje më 11 dhjetor pas javësh protesta kundër korrupsionit.

Mijëra persona kanë protestuar në Bullgari kundër planeve buxhetore të qeverisë, duke e detyruar më pas ekzekutivin që të heqë dorë nga to. Më pas, protestuesit kërkuar kërkuar dorëheqjen e kabinetit qeverisës. Zhelyazkov njoftoi për dorëheqjen e tij përmes një deklarate të transmetuar nga

televizionet, disa minuta para se parlamenti ishte paraparë të votonte për një mocion mosbesimi ndaj ekzekutivit.

Dorëheqja e qeverisë vjen pak para se Bullgaria t'i bashkohet eurozonës më 1 janar 2026. “Koalicioni ynë u takua, ne diskutuam për situatën aktuale, për sfidat me të cilat përballemi dhe vendimet që duhet t'i marrim me përgjegjësi”, tha Zhelyazkov, gjatë njoftimit për dorëheqje. “Dëshira jonë është që të jemi në nivelin që pret

shoqëria. Pushteti buron nga zëri i qytetarëve”, theksoi ai.

Pavarësisht se qeveria tërhoqi vendimin për buxhetin, protestat në Sofja dhe dhjetëra qytete bullgare vazhduan, me qytetarët që kanë kundërshtuar korrupsionin dhe dështimin e qeverive të njëpasnjëshme të vendit për ta luftuar atë.

Partitë opozitare dhe organizatat e tjera kanë deklaruar se po protestonin kundër planeve për rritjen e kontributeve për sigurime



sociale dhe taksave mbi shpenzime më të larta dividendën për të financuar shtetërore.

RAPORTI “KOSTOJA E POLITIKËS NË KOSOVË”, MBI 12 MIJË EURO SHPENZIME PËR T’U BËRË DEPUTET

Democracy Plus (D+) dhe Westminster Foundation for Democracy (WFD) kanë publikuar raportin “Kostoja e politikës në Kosovë”, një studim që analizon shpenzimet e kandidatëve për deputetë gjatë zgjedhjeve nacionale të vitit 2025. Gjetjet kryesore të raportit tregojnë rritje të koston së fushatave, varësi të lartë nga financimi personal dhe pabarazi mes burrave dhe grave në shpenzimet zgjedhore. Në bazë të raportit rezulton se mesatarja e shpenzimeve për një kandidat është 9 mijë e 463 euro, ndërsa kandidatët fitues shpenzojnë mesatarisht 12 mijë e 150 euro, kurse ata të pazgjedhur shpenzojnë 4 mijë e 90 euro

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Democracy Plus (D+) dhe Westminster Foundation for Democracy (WFD) kanë publikuar raportin “Kostoja e Politikës në Kosovë”, një studim që analizon shpenzimet e kandidatëve për deputetë gjatë zgjedhjeve nacionale të vitit 2025, si dhe ndikimin e tyre në konkurrencën politike, barazinë e mundësive dhe integritetin zgjedhor. Gjetjet kryesore të raportit tregojnë rritje të koston së fushatave, varësi të lartë nga financimi personal dhe pabarazi mes burrave dhe grave në shpenzimet zgjedhore. Në bazë të raportit rezulton se mesatarja e shpenzimeve për një kandidat është 9 mijë e 463 euro, ndërsa kandidatët fitues shpenzojnë mesatarisht 12 mijë e 150 euro, kurse ata të pazgjedhur shpenzojnë 4 mijë e 90 euro. Sipas raportit, gratë kanë shpenzuar më shumë krahasuar me shpenzimet e burrave gjatë fushatës zgjedhore. Graeme Ramshaw, drejtor për Cilësi dhe Inovacion në Fondacionin Westminster për Demokraci, tha se raporti është fokusuar në mënyrë të veçantë te rinia dhe gratë në garën zgjedhore. “Për t’u bërë deputet është problem, aq sa edhe marrja e pozitës së deputetit. Kemi shikuar se sa shpenzime bëhen dhe sa presion ushtrohet. Donim të bënim një fokus te gratë dhe rinia. Ndërsa studimet janë akumuluar në këtë projekt, kemi parë disa kontekste shtetërore, shoqërore dhe ekonomike. Fushatat po bëhen më të shtrenjta. Kandidatët po mbështeten në financim personal, ndërsa gratë marrin hua nga të afërmit”, tha ai.

Albert Krasniqi, drejtor i Programeve në “Demokrati Plus”, paraqiti gjetjet e raportit “Kostoja e politikës në Kosovë”, duke shpjeguar metodologjinë dhe rezultatet e hulumtimit. “Kemi përdorur analizën e kornizës ligjore, intervista gjysmë të strukturuar me 15 kandidatë, 10 deputetë dhe 5 kandidatë për deputetë. Gjithashtu kemi realizuar dy fokus-grupe, njërin me politikanë dhe tjetrin me aktivistë të shoqërisë civile, gazetarë dhe ekspertë”, tha Krasniqi. Në raport bëhet me dije se rekrutimi i kandidatëve në partitë kryesore të Kosovës pasqyron presione të përbashkëta sistemore dhe tradita specifike partiake. “Një krahasim ndërpartiak i tri partive kryesore në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 tregon se, ndonëse kriteret formale shpesh përmendin integritetin, profesionalizmin, balancën gjinore dhe përfaqësimin, në praktikë rekrutimi formësohet më pak nga aktivizmi afatgjatë partiak dhe më shumë nga popullariteti i jashtëm, burimet financiare dhe mbështetja e liderit. Kjo pasqyron një trend më të gjerë të figurave ‘të gatshme’ politike që hyjnë në politikë mbi bazën e dukshmërisë apo pasurisë sesa përmes socializimit gradual politik”, thuhet në raport. Krasniqi tha se janë kryer analiza me tri partitë kryesore: LV, PDK dhe LDK. “Sa i përket rekrutimit, kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje na kanë thënë se kriteret përfshijnë aspektin gjeografik të përfaqësimit dhe ndikimin në zonat prej nga vijnë; aftësinë polarizuese të kandidatëve në kuptim të përfaqësimit të temave qendrore politike dhe ballafaqimit me rivalët; aktivistët e hershëm dhe ata me pushtet ekzekutiv; afërsinë me liderin dhe strukturat e partisë;



si dhe figura nga akademja dhe bota e shoubizit. Ndërsa nga Partia Demokratike e Kosovës na kanë thënë se kandidatët duhet të mos kenë aktakuza, të jenë profile publike dhe të profilizuara në fusha të caktuara; mosha dhe kandidatë që nuk kanë pasur angazhime të mëhershme politike; historiku i kontributit për vendin dhe lidhjet me luftën e UÇK-së. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, kriteret përfshijnë ruajtjen e votës konservatore të LDK-së, profilin profesional, lidhjet e krijuara me komunitetin e biznesit ose kuptimin e zhvillimit ekonomik, si dhe afërsinë me leadershipin e partisë. Këto kanë qenë partitë kryesore me të cilat kemi realizuar analizën. Shpenzimet nga partitë politike, sipas tyre, janë të ndara në tri fusha: takimet me qytetarët; prania dhe ndikimi digjital; si dhe stafi i fushatës zgjedhore dhe aktivitetet për ditën e zgjedhjeve”, tha ai. Krasniqi paraqiti shpenzimet për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve të shkurtit, derisa theksoi se gratë kanë bërë shpenzime më të mëdha. “Sa i përket lidhjes mes shpenzimeve dhe suksesit zgjedhor, rezulton se ata që kanë shpenzuar deri në 2 500 euro, nga tre kandidatë asnjëri nuk ka siguruar ulëse në Kuvendin e Kosovës. Shpenzuesit mesatarë, me 2 500 deri në 7 999 euro, nga katër kandidatë tre kanë fituar. Ndërsa shpenzuesit mbi 8 000

euro nga tetë kandidatë shtatë e kanë siguruar ulësen. Mesatarja për një kandidat është 9 463 euro; kandidatët fitues shpenzojnë mesatarisht 12 150 euro, ndërsa kandidatët e pazgjedhur 4 090 euro. Gratë kanë qenë më shpenzuese në fushatën zgjedhore: gratë kanë shpenzuar rreth 15 mijë euro, ndërsa burrat rreth 6 000 mijë euro”, prezantoi ai. Kandidati për deputet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, tha se rrjetet sociale kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve. “Raporti vjen në një moment të rëndësishëm për shkak se jemi në një proces zgjedhor dhe po shoh që është një temë aktuale që shpeshherë nuk është e gjerë në publik, por është shumë e pranishme në diskutime të ngushta mes familjes apo shoqërisë. Kostoja politike në Kosovë është duke u rritur jashtëzakonisht shumë, është duke rritur si barrë politike për organizatat politike, në këtë rast partitë, por në veçanti për ata që duan të marrin një funksion publik, siç është një ulëse në kuvend apo në asamble komunale apo edhe marrja e një mandati kryetar komune. Jam prej moti në organizim politik. Prej vitit 2007 kam funksione në parti dhe mbaj mend një kohë kur në seli kemi pasur një kompjuter dhe unë si zëdhënës e kam lëshuar kumtesën në mbrëmje dhe në mëngjes e kemi ditur kush po vjen. Kanë qenë disa aktivitete nëpër komuna dhe me kaq është përmbyllur fushata.

Trendët dhe ndikimi i rrjeteve sociale kanë bërë që forma ta mbyttë përmbytjen dhe arsyeja që është rritur financimi dhe kostoja i të qenit udhëheqës i partisë, por të njëjtën edhe kandidatë lidhur me formën”, tha ai. Ish-kryetarja e Komisionit Zgjedhor të Kosovës, Valdete Dakaj, tha se gratë kanë fituar falë votave dhe se nuk kanë mbështetje. “Jemi në një çështje që edhe pas 26 vjetësh pas luftës ka mbetur një prej temave më të ndjeshme prej skenës politike. Meqenëse jam grua dhe meqenëse një kohë të gjatë kam qenë në krye të institucioneve i cili i organizon zgjedhjet, kisha dashur të fokusohem në pozitën e gruas në zgjedhje edhe në politikë, me theks të veçantë në financimin e fushatës zgjedhore dhe fuqinë e grave në politikë. Sikur që e dini, gratë një kohë të gjatë kanë fituar ulëse në parlament duke iu falënderuar kuotës gjinore, si një prej mekanizmave mbrojtës dhe mbështetës për gratë ia kanë mësyre politikës e sidomos ulëses në parlament. Ka një kohë që gratë kanë fituar ulëse duke marrë vota të cilat i kanë fituar, por sa kanë pasur mbështetje dhe sa ka qenë financimi i përkrahur është një çështje për t’u diskutuar. Besojmë jemi të vetëdijshëm se kostoja politike është jashtëzakonisht e lartë e sidomos duke marrë parasysh rrethanat ekonomike të Kosovës dhe situatë financiare të kandidatëve”, tha Dakaj.

BEDRI HAMZA SHPALOS PROGRAMIN QEVERISËS PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT: BASHKË, PËRPARA

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Kryetari dhe kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, në prezantimin zyrtar të kandidaturës së tij dhe listës së kandidatëve për deputetë të PDK-së, ka zbuluar sloganin e fushatës së Zgjedhjeve të Përgjithshme të 28 dhjetorit.

Hamza, në një tubim madhështor në mesin e strukturave dhe mbështetësve të PDK-së, ka thënë se “Bashkë, përpara”, përveç slogan, është edhe zotim për t’u ribashkuar dhe për ta rikthyer Kosovën në rrugën e zhvillimit. “Kosova meriton të jetë më mirë. Dhe ne do ta bëjmë ma të mirë! Sepse ne do të ecim bashkë, përpara. Bashkë, përpara është edhe slogani ynë në këto zgjedhje. Sepse ky është drejtimi ynë. Ky është misioni ynë. Sepse bashkimi, duke u bërë bashkë rreth vlerave, parimeve dhe politikave, është ‘pjesa që mungon’ në mozaikun e Kosovës, e cila po na mban të ndarë. Shteti përparon duke u bashkuar, jo duke u përçarë”, ka theksuar ai.

Hamza tha se qeveria e udhëhequr nga ai do t’i përfshijë të gjitha forcat politike që janë të gatshme të ecin “Bashkë, përpara”. “Le ta nisim së bashku këtë mision të ri kombëtar në vitin 2026. Le ta sjellim pjesën që mungon, që t’i kompletojë aspiratat dhe shpresat tona. Le t’i bashkojmë përpjekjet për ta ndërtuar një Kosovë që funksionon për të gjithë. Një Kosovë të mundësive. Një Kosovë stabiliteti. Një Kosovë drejtësie. Një Kosovë shprese. Një Kosovë që na bën bashkë dhe nuk e lë askënd pas! Bashkë. Përpara. Bashkë do të fitojmë.



Kosova do të ecë përpara”, ka thënë ai.

Hamza ka thënë se programi dhe vizioni i tij mbështetet në disa shtylla: zhvillim ekonomik, drejtësi të pavarur dhe efikase, arsim dhe shëndetësi bashkëkohore, mbrojtje dhe siguri. “Ne do t’i rrisim pagat dhe pensionet. Do të ketë rritje të pagave 50 % mbi pagën aktuale, për mësues e arsimtarë, policë e zjarrfikës, mjekë e ushtarë dhe për të gjithë ata që marrin paga nga buxheti i Republikës së Kosovës. Do ta ndryshojmë shkallën e tatimit për të

ardhurat: Të ardhurat deri në 400 euro - zero tatim. 400 deri në 800 euro - vetëm 8 %. Mbi 800 euro - 10 %. Do ta shfuqizojmë ligjin aktual të tatimit në pronë, që të mos ketë barrë të papërbalueshme mbi qytetarët dhe bizneset”, ka thënë ai, duke shtuar se do të japin bursa - fond prej 30 milionë euro në vit, që çdo student të ketë mundësi të shkollohet e t’i arrijë kapacitetet e veta. “Ndërsa universitetet e Kosovës do t’i lidhim me industrinë, që të prodhojmë kuadro që i nevojiten Kosovës. Për të moshuarit do të

ndërtojmë qendra të veçanta kujdesi për ta, në çdo rajon të Kosovës. E për ata me sëmundje kronike, ilaçe falas. Pa barrë financiare”, ka shtuar më tej ai.

Sipas Hamzës, me stabilitet brenda dhe kredibilitet jashtë, Kosova më në fund do ta marrë vendin që i takon në familjen evropiane. “Do ta modernizojmë infrastrukturën mbrojtëse të vendit që Kosova duhet të jetë e përgatitur për çdo kërcënim, të brendshëm, të jashtëm. Do ta krijojmë Gardën Kombëtare të Kosovës, forcë operative, e shpejtë, e pajisur

sipas standardeve të NATO-s. E gatshme për emergjencë, siguri dhe pjesëmarrje në misione ndërkombëtare. Anëtarësimi në NATO e në BE për ne nuk ka alternativë. Prandaj do ta thellojmë partneritetin me NATO-n. Do të punojmë që sa më parë të bëhemi pjesë e Partneritetit për Paqe. Do ta rifillojmë Dialogun Strategjik me ShBA-në, që sa më shpejt të arrijmë te Marrëveshja Strategjike me ShBA-në. Dhe po, do të punojmë për anëtarësimin në Këshillin e Evropës dhe ta marrim statusin e kandidatit në BE”, ka thënë ai.

Hamza ka thënë se platforma e tij dhe ekipit të tij nuk është listë premtimesh, por plan koherent, i llogaritur, realist dhe i përgjegjshëm, që ua rikthen dinjitetin qytetarëve. “E dimë se në Kosovë mund të bëhet ma mirë vetëm me ne të bashkuar! Qytetarë të dashur, viti 2025 ishte vit i jostabilitetit. Vit i përçarjeve politike. Vit i shtrenjtë, i lodhshëm dhe i pashpresë për qytetarët. Le ta përmirësojmë këtë. Viti 2025 ishte viti i pestë pa presidentin Thaçi, kryetarin Veseli, bacën Jakup e Rexhën në Kosovë. Por, në vitin 2026 edhe ata do të rikthehen pranë nesh, pranë familjeve të tyre, në shtetin e tyre. Në vitin 2026 të gjithë duhet të jemi bashkë. Me stabilitet politik. Me stabilitet ekonomik. Me stabilitet shoqëror. Tani është koha të provojmë diçka tjetër. Tani është koha ta provojmë bashkimin. Kosova që funksionon fillon me bashkimin e të gjithë neve. Kosova që funksionon kërkon qeveri të qëndrueshme dhe efektive. Një qeveri stabile, që krijon konsensus sa më të gjerë, për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve”, ka thënë Hamza.

ULUTASH: KOMUNIKIMET E RREGULLTA ME USHTRINË SERBE, VITALE PËR TË PARANDALUAR PËRSHKALLËZIME

Prishtinë, 11 dhjetor - Komandanti i misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, gjeneralmajor Ozkan Ulutash, tha se komunikimet rregullta me ushtrinë serbe janë të rëndësishme për ta parandaluar çdo përshkallëzim të mundshëm.

Ulutash i bëri këto deklarata pas vizitës në Serbi, ku u takua me kreun e ushtrisë serbe, gjeneralin Millan Mojsiloviç. “Komunikimet e rregullta dhe të hapura mes KFOR-it dhe Forcave të Armatosura të Serbisë janë vitale për t’i adresuar zhvillimet e rëndësishme dhe për të parandaluar çdo rrezik të mundshëm të përshkallëzimit me kohë, në mënyrë të duhur, transparente dhe konstruktive.

Në javët dhe muajt në vijim unë do të bëj pjesën time për t’u siguruar që të vazhdojmë t’i shfrytëzojmë sa më mirë këto komunikime të rregullta”, tha Ulutash përmes një deklarate. Edhe gjatë mandatit të parë të tij në krye të KFOR-it, Ulutash kishte vizituar Beogradin. Ulutash e falënderoi për mikpritjen Mojsiloviçin me të cilin tha se “veçse kam zhvilluar një bashkëpunim të hapur dhe frytdhënës gjatë mandatit tim të parë në krye të KFOR-it. Mezi pres të takohem sërish me të, së shpejti”.

Kreu i KFOR-it tha se misioni është i angazhuar për të ofruar siguri që “mundëson krijimin e kushteve të nevojshme për dialog politik”. “NATO - përfshirë përmes punës së përditshme të KFOR-it -



vazhdon ta mbështesë dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian mes Prishtinës dhe Beogradit si kornizë për t’i adresuar çështjet e mbetura me qëllim që të përfitojnë të gjithë njerëzit”, tha Ulutash.

Sipas gjeneralmajorit Ulutash,

ky mision për çerekshekulli ka luajtur rol kyç në mirëmbajtjen e paqes dhe duke ofruar siguri për të gjithë qytetarët në Kosovë. Siguria në rajon, sipas gjeneralmajorit turk, është e lidhur me sigurinë e Evropës dhe në mbarë zonën

euroatlantike.

Gjeneralmajori turk u rikthye në drejtimin e KFOR-it në muajin tetor. Mandati i parë njëvjeçar i Ulutashit në krye të KFOR-it nisi në tetor të vitit 2023 dhe përfundoi në tetor të vitit pasues.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX.

KFOR-i, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

NATO-ja e shtoi praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

Në KFOR aktualisht janë mbi 4 000 paqeruajtës nga vende të ndryshme të botës.

UP dhe Ambasada e Hungarisë diskutojnë mundësinë e hapjes së kursit të gjuhës hungareze

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Prorektorja për Ndërkombëtarizim dhe Shkëmbime Akademike e Universitetit të Prishtinës, prof. Rozafa Basha, priti në takim ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Laszlo Istvan Dux dhe sekretarin e parë të ambasadës, Aron Kerékgyártó. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mundësisë së sjelljes së një lektori të gjuhës hungareze për të ofruar kurs të gjuhës hungareze në kuadër të Qendrës së Gjuhëve në Fakultetin e Filologjisë dhe potencialisht, hapja e një

lektorati të gjuhës hungareze në të ardhmen. Gjatë vizitës së tij të parë zyrtare në Rektorat në tetor të këtij viti, me ambasadorin Dux ishte diskutuar, ndër të tjera, zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet UP-së dhe institucioneve të arsimit të lartë në Hungari, si edhe mundësia e ofrimit të kurseve të gjuhës hungareze për studentët tanë. Takimi i sotëm shërbeu për të konkretizuar këto ide dhe për t'i shqyrtuar hapat e mundshëm përpara. Në takim morën pjesë edhe prof. Milote Sadiku, prodekane

për bashkëpunim ndërkombëtar në Fakultetin e Filologjisë dhe prof. Lindita Sejdiu, udhëheqëse e Qendrës së Gjuhëve. Ato paraqitën mënyrën e organizimit të kurseve të gjuhës në qendër, kushtet e punës për lektorët, si dhe aspektet e tjera organizative të Qendrës së Gjuhëve. Palët diskutuan për afatet më të përshtatshme për angazhimin e mësimdhënësit dhe mundësitë për zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj nisme. Qendra e Gjuhëve në Fakultetin e Filologjisë po e zgjeron



vazhdimisht ofertën e saj të gjuhëve të huaja, ndërsa UP po forcon më tej bashkëpunimin

ndërkombëtar me synim rritjen e mundësive akademike për studentët dhe stafin.

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS FORCON BASHKËPUNIMIN ME DKA-të PËR AVANCIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLAVE

PRIZREN, 11 DHJETOR - Në ambientet e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren është mbajtur tryeza e diskutimit me temë “Avancimi i performancës së shkollës bazuar në dëshmi: përvoja dhe praktika”, organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) në bashkëpunim me DKA-në. Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit institucional për përmirësimin e performancës së shkollave, me fokus të veçantë në zhvillimin e aftësive të lexim-kuptimit dhe lexim-shkrimit të nxënësve. Tryezën e hapi drejtoresha e DKA-së në Prizren, Luljeta Veselaj-Gutaj, e cila falënderoi IPK-në për bashkëpunimin e



vazhdueshëm dhe përkushtimin për ngritjen e cilësisë së arsimit. Ajo, gjithashtu, shprehu

mirënjohje për mësimdhënësit, pedagogët, psikologët dhe drejtorët e shkollave që morën

pjesë në tryezë. Tryeza u planifikua dhe u moderua nga Tringa Dedi, bashkëpunëtoresh shkencore /shefe e Departamentit për Mbështetje Profesionale Pedagogjike në IPK dhe koordinatorë e këtij aktiviteti, e cila theksoi rëndësinë e diskutimeve të orientuara në evidenca dhe nevojën për qasje të sinkronizuara ndërmjet institucioneve arsimore. Agim Bytyçi nga Sektori i Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Prizren në hapje të tryezës dha një orientim për qasjen bashkëpunuese që ka SIA me DKA-të dhe Shkollat dhe për fokusin e SIA-s në temat e përcaktuara për këtë tryezë

diskutimi. Selim Mehmeti në emër të drejtorit të IPK-së, Buleshkaj, i falënderoi pjesëmarrësit për kohën dhe kontributin e tyre, si dhe DKA-në për pritjen dhe bashkëpunimin e ofruar gjatë aktivitetit. Mehmeti ka paraqitur disa pika që lidhen me ndërlidhjen e planeve zhvillimore me zhvillimin profesional të mësimdhënëseve. Ai u fokusua në zhvillimin profesional me bazë në shkollë, zhvillimet në këtë komponentë nga Këshilli për Licencim të Mësimdhënëseve dhe projekti KosEd për udhëzuesin për shkollat dhe qasjet që duhet t'i ndjekin shkollat ndaj zhvillimit profesional me bazë në shkollë.

ODA E AVOKATËVE ALARMON, DYSHON PËR PAJISJE TË DYSHIMTA INCIZIMI NË DISA OBJEKTE TË POLICISË SË KOSOVËS

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si avokatë, kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, Besnik R. Berisha dhe nënkryetari Naim Rudari, në disa raste dhe në disa objekte të Policisë së Kosovës kanë vërejtur pajisje incizimi që në dukje ngjasojnë me kamera artizanale, të vendosura në hapësira ku zhvillohen intervistat dhe konsultat konfidenciale ndërmjet avokatëve dhe palëve. Duke e konsideruar këtë situatë një rrezik të drejtpërdrejtë për

standardet e konfidencialitetit dhe të drejtave procedurale, Oda e Avokatëve e Kosovës ka ndërmarrë menjëherë veprimet institucionale dhe ka kërkuar sqarim zyrtar nga Policia e Kosovës. Në përgjigjen e saj, policia ka njoftuar se pajisjet: 1. Janë instaluar rreth tre vite më parë si pjesë e një projekti zyrtar për sistemet audio/video në dhomat e intervistimit; 2. Nuk përbëjnë pajisje të fshehta, ilegale apo të menaxhuara nga stafi hetues; 3.



Nuk janë funksionalizuar dhe nuk kanë gjeneruar asnjë incizim; 4. Janë vendosur në kuadër të një projekti të koordinuar me

institucionet kompetente. Megjithatë, Oda e Avokatëve vlerëson se prania e pajisjeve që në dukje ngjasojnë me kamera artizanale, pa shenja të dukshme identifikuese, pa sinjalizim teknik dhe pa njoftim paraprak, krijojnë pasiguri të justifikuar dhe bie ndesh me standardet e konfidencialitetit që garantojnë ushtrimin e profesionit të avokatit. Për këtë arsye, OAK-u u bënë thirrje të gjithë avokatëve që të jenë maksimalisht vigjilentë dhe

të mos zhvillojnë konsultime konfidenciale në hapësira ku ekziston dyshim mbi sigurinë teknike apo privatësinë e bisedës, pavarësisht prej përgjigjes së dhënë nga policia.. Oda e Avokatëve e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar ndaj mbrojtjes së standardeve profesionale të avokatëve, të drejtave procedurale të palëve dhe garantimit të kushteve të sigurta e të pandryshueshme të konfidencialitetit në të gjitha hapësirat e intervistimit.

Fillon punën Zyra Mobile Lëvizëse e ANJF-së në Kastriot

KASTRIOT, 11 DHJETOR - Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) në ditën e fundit të fushatës globale “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” ka funksionalizuar Zyrën Mobile lëvizëse për Ndihmë Juridike Falas në komunën e Kastriotit falë bashkëpunimit të ngushtë

mes Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, projektit të UNDP-së “Voices of Justice” dhe komunës së Kastriotit. Qëllimi i Zyrës Mobile Lëvizëse është rritja e qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët, në komunat ku ANJF nuk ka zyrë statike, si dhe me fokus të veçantë te

grupet më të cënueshme të shoqërisë. Në hapjen e aktivitetit të Zyrës morën pjesë ushtruesi i detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu; kryetari i komunës së Kastriotit, Halil Thaçi; si dhe drejtori i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Faton

Jashari. Me këtë rast u theksua rëndësia e Zyrës Mobile si një mekanizëm i rëndësishëm për ofrimin e shërbimeve juridike falas më afër qytetarëve, veçanërisht atyre që përballen me vështirësi financiare ose kushte të pafavorshme sociale. Zyra Mobile Lëvizëse e ANJF-së do të qëndrojë për një muaj



në komunën e Kastriotit për të vazhduar më pas në zona të tjera në nivel vendi sa më afër qytetarëve.

KURTI: TË AKUZUARIT PËR SHPËRTHIMIN NË IBËR-LEPENC ISHIN TË LIDHUR ME SHTETIN E SERBISË

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se të dhënat e inteligjencës tregojnë se tre serbët e akuzuar për shpërthimin në kanal jetik të ujit, Ibër-Lepenc, kanë qenë të lidhur ngushtë me strukturat shtetërore të Serbisë.

Të martën prokurorët e Kosovës ngritën aktakuzë ndaj Jovan Viqentijeviq, Dragisha Viqentijeviq dhe Igor Dimoviq për shpërthimin e vitit të kaluar në kanal jetik të ujit që furnizon dy termocentralet kryesore të vendit. Ata akuzohen se shpërthyen 20 kilogramë të llojit TNT në kanal, duke dëmtuar strukturën e tij prej betoni, ndërprerë furnizimin me ujë të pijshëm dhe duke penguar sistemin e ftohjes për termocentralet me qymyr, gjë që ngriti shqetësime për ndërprerje të rrymës.

Që të tre janë arrestuar pas sulmit. Në një shkrim në “Facebook”, Kurti i përsëriti deklaratat e mëparshme se “sulmi ka ardhur nga Serbia, fqinji ynë verior, agresiv e armiqësor”. “Tashmë është në rrugë të mbarë hetimi i këtij



rasti, ku janë siguruar prova se pikërisht tre serbët e akuzuar ishin në vendin e ngjarjes natën kritike, për ç’gjë falënderoj institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës dhe FBI-në nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për punën profesionale të kryer në këtë rast”, ka shkruar Kurti.

Ai nguli këmbë se gjykimi në këtë rast “do ta dëshmojë se të akuzuarit ishin pjesë e strukturave ilegale të Serbisë, të lidhur ngushtë me mikun e

[presidentit të Serbisë Aleksandar] Vuçiçit, terroristin Millan Radoiçiq, dhe strukturat e tjera shtetërore të Serbisë që planifikuan dhe urdhëruan sulmin terrorist”.

Kurti po i referohej ish-nënkryetarit të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në vend, Millan Radoiçiq, të cilin autoritetet e Kosovës e kërkojnë me fletarrestim për vepra të ndryshme penale, përfshirë për një sulm vdekjeprurës kundër Policisë së Kosovës në veri të

vendit më 2023.

Radoiçiqi e mori përgjegjësinë për atë sulm ku u vra një rreshter i Kosovës dhe tre sulmues serbë. Kosova e cilëson si “akt terrorist” shpërthimin në kanal jetik të ujit në Varragë të Zubin Potokut dhe e akuzon Serbinë se qëndron pas tij, por Beogradi e ka mohuar vazhdimisht se ka gisht. “Përkundër faktit se Beogradi zyrtar mohonte përgjegjësinë dhe u angazhua fuqishëm përmes veprimeve hibride në dezinformimin e opinionit,

Çfarë është Ibër-Lepenci?

Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër-Lepenc, me seli në Prishtinë, është një ndërmarrje që furnizon me ujë të papërpunuar industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë, si dhe prodhon energji elektrike nga hidrocentrali i Ujmanit. Sipas faqes zyrtare të kësaj ndërmarrjeje, kompania është themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës më 28 shkurt 1967. Ndërtimi i këtij sistemi u bë në dy faza: Faza e Ibrit, e cila përfundoi më 1986, dhe faza e Lepencit, e cila nuk u realizua. Kjo ndërmarrje sot është shoqëri aksionare, 100 % në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

duke ngritur dyshime nga më të ndryshmet për përgjegjësit apo motivet e aktit terrorist, aktakuza e ngritur dhe epilogu i rastit, pa fije dyshimi, do të konfirmojnë të dhënat dhe vlerësimet e institucioneve të Kosovës”, ka shkruar Kurti.

MBROJTJA E SINJALIZUESVE NË KOSOVË: ‘MES LIGJIT DHE REALITETIT’

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Lëvizja FOL ka organizuar tryezën e diskutimit “Mbrotjtja e sinjalizuesve në Kosovë: Mes ligjit dhe realitetit”, në kuadër të “Javës Kundër Korrupsionit 2025”.

Drejtoresha ekzekutive e Lëvizjes FOL, Mexhide Demolli-Nimani, tha se qëllimi i kësaj tryeze është të mbledhë në një vend sinjalizues, përfaqësues institucionalë, ekspertë ligjorë dhe organizata të shoqërisë civile, për t’i diskutuar sfidat dhe mundësitë në zbatimin praktik të Ligjit për Mbrotjtjen e Sinjalizuesve, sidomos në rastet kur preken interesa të mëdha ekonomike dhe buxheti i shtetit. “Edhe pse Kosova ka një ligj relativisht të avancuar për mbrotjtjen e sinjalizuesve, zbatimi i tij vazhdon të përballet

me pengesa serioze: mungesë informimi nga shumë udhëheqës institucionalë, keqkuptim të rolit të ‘sinjalizuesit’ dhe ‘zyrtarit përgjegjës’ (si në rastin e KPK-së), si dhe vështirësi reale për ta garantuar konfidencialitetin e raportimit”, u shpreh ajo.

Ajo shtoi se në sektorin privat situata është edhe më sfiduese: shumica e bizneseve nuk janë të informuara për ekzistimin e ligjit, mungon caktimi i zyrtarëve përgjegjës, inspektimet janë të pakta, nuk ka procedura kundërvajtëse të iniciuara, raportimi vjetor pothuajse mungon, dhe vetëm rreth 40 % e të punësuarve shprehen të gatshëm të sinjalizojnë - një tregues i qartë i frikës dhe mosbesimit në mekanizmat aktualë.

Milot Shala, udhëheqës i Divizionit për Sinjalizim në



Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, tha se vetëdijësimi për sinjalizim është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Sipas tij, institucionet publike kanë raportuar 20 sinjalizime në vitin 2023, 50 raste në vitin 2024, dhe afër 90 raste këtë vit, çka përbën një dëshmi se sinjalizimi po shfrytëzohet gjithnjë e më

shumë si mekanizëm ligjor.

Në tryezë foli edhe avokati Ardian Bajraktari, përfaqësues i sinjalizueses Makfirete Dibrani, udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore në MMPHI, e cila kishte raportuar keqpërdorime financiare brenda ministrisë. Ai tregoi reagimet institucionale,

përfshirë përgjigjen e Policisë së Kosovës, duke theksuar se rasti i Dibranit ka ngritur një debat publik të rëndësishëm për guximin qytetar dhe ndikimin e sinjalizimit në mbrotjtjen e buxhetit të shtetit.

Bajraktari, po ashtu, tha se Dibrani është përballur me kërcënime, duke e cilësuar këtë si tregues të mungesës së angazhimit serioz institucional për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

Flamur Kabashi, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), tha se sinjalizuesit duhet të shihen si mbrotjtës të interesit publik dhe të shtetit, e jo si kundërshtarë të institucioneve, siç shpesh perceptohen.

“Java Kundër Korrupsionit 2025” organizohet nga Koalicioni i Organizatave të Shoqërisë Civile, FOL, IKD dhe INPO, me moton “Bashkë Kundër Korrupsionit”.

Nxënësit vetëdijesohen për rrezikun nga mjetet piroteknike

Prishtinë, 11 dhjetor - Forca e Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në kuadër të planit vjetor, është duke realizuar ligjëratat vetëdijesuese me temën “Rreziku nga mjetet piroteknike” për nxënësit e Shkollave të Mesme të Ulëta në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtyre ligjëratave është informimi dhe sensibilizimi i nxënësve për pasojat dhe rreziqet që shkaktohen nga përdorimi i mjeteve piroteknike, veçanërisht gjatë periudhave festive.

Pjesëtarët e FSK-së po prezantojnë shembuj praktikë, rregullat e sigurisë dhe mënyrat se si fëmijët dhe të rinjtë mund

t’i shmangin incidentet që mund të rezultojnë me lëndime të rënda gjatë përdorimit të këtyre mjeteve.

FSK-ja mbetet e përkushtuar në misionin e saj për sigurinë e qytetarëve dhe në ndërgjegjësimin e brezave të rinj për çështjet që prekin mirëqenien dhe shëndetin publik.



BANKA ZHVILLIMORE E KËSHILLIT TË EVROPËS VLERËSON PËRPARIMIN E BQK-së NË FORCIMIN E KORNIZËS MBIKËQYRËSE

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore e Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Milot Cakaj, zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (CEB), Thomas Adams, menaxher i vendit përgjegjës për Gjermani dhe Kosovë, si dhe Denis Weerts, menaxher i Lartë për Rrezikun e Kredive. Diskutimet u fokusuan në zhvillimet e fundit në sektorin financiar, me theks atë të mikrofinancave dhe institucioneve jobankare financiare (MFI/NBFI), avancimin e përfshirjes financiare dhe reformat strukturore dhe rregullatore të ndërmarra nga BQK. Në fillim të takimit guvernatori Ismaili paraqiti zhvillimet e fundit në sektorin financiar, duke përfshirë atë të mikrofinancave dhe jo bankave,



duke theksuar rolin e këtyre institucioneve në zgjerimin e qasjes ndaj financave për segmente të caktuara të ekonomisë dhe popullsisë. Ai vuri në dukje se sektori operon me një model unik biznesi që mbështet huamarrjen për mikro-ndërmarrjet dhe individët me qasje të kufizuar në shërbimet tradicionale bankare, duke ruajtur një nivel të ulët të kredive me problem dhe një profil të qëndrueshëm risku. Guvernatori Ismaili, gjithashtu, informoi përfaqësuesit e CEB-it

mbi forcimin e kornizës rregullatore dhe mbikëqyrëse për MFI dhe NBFI, duke përfshirë kërkesat e reja për licencim dhe kapital, praktikën e përmirësuar të mbikëqyrjes dhe aktivitetet e vazhdueshme për parandalimin e pastrimit të parave (AML). Ai theksoi se BQK-ja ka avancuar strukturën e brendshme organizative për të siguruar një mbikëqyrje më efektive të këtyre institucioneve, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe objektivat strategjike të BQK-së.

Diskutimet gjithashtu përfshin përpjekjet e zgjeruara të BQK-së në edukimin financiar. Këto iniciativa synojnë ta forcojnë përfshirjen financiare, ta përmirësojnë efikasitetin dhe ta mbështesin zhvillimin afatgjatë të infrastrukturës financiare të Kosovës. Adams dhe Weerts vlerësuan përpjekjet e BQK-së në forcimin e kornizës mbikëqyrëse, promovimin e përfshirjes financiare dhe avancimin e digjitalizimit. Ata rikonfirmuan interesin e vazhdueshëm të CEB-së për ta mbështetur zhvillimin e

qëndrueshëm, ndikimin social dhe financat gjithëpërfshirëse në Kosovë. Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen për Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, duke theksuar se BQK-ja vlerëson lart partneritetet që mbështesin reformat institucionale, modernizimin e sektorit financiar dhe përmirësimin e qasjes në financa për qytetarët dhe bizneset. Ai rikonfirmoi gatishmërinë e BQK-së për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me CEB-në përmes projekteve dhe iniciativave të prioritetit strategjik të BQK-së. Në takim u nënvizua përkushtimi i përbashkët i të dy institucioneve për ta forcuar gjithëpërfshirjen financiare, praktikën rregullatore dhe reformat që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës.

ÇMIMET HAVA NË KOSOVË: PEMËT SHTRENJTOHEN 16 %, RRYMA 15,5 % E MISHI GATI 14 %

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin nëntor 2025, viti bazë 2015=100. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 5,3 % në muajin nëntor 2025, krahasuar me muajin nëntor 2024. Inflacioni mujor ishte 0,4 % në muajin nëntor 2025. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 5,3 % në muajin nëntor 2025 krahasuar me muajin nëntor 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it:

shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (18,1 %); pemë (16,1 %); energji elektrike (15,5 %); bileta të fluturimeve (14,6 %); mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve personale të transportit (14,1 %); kafe, çaj dhe kakao (14 %); mish (13,7 %); pushime të organizuara (13,5 %); qumësht, djathë dhe vezë (10,5 %); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (9,6 %); shërbime ambulantore (8,9 %); shërbime hoteliere (8,8 %); pajisje terapeutike (8,4 %); duhan (6,4 %); kujdes personal (5,9 %); vajra dhe yndyra (5,9 %); prodhime ushqimore (5,8 %); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,3 %); bukë dhe drithëra (5,2 %); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (5,0 %); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (4,5 %); pije alkoolike (4,4 %);



mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (4,2 %); arsim (3,8 %); gjëra personale (3,7 %); furnizim me ujë dhe shërbime të ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3,5 %); perime (3,3 %); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (3 %); gazeta, libra dhe materiale për zyra (2,9 %); veshje (2,7 %); dhe transport rrugor i udhëtarëve (1,4 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 5,4-

përqindësh në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-0,8 %); dhe blerje e automjeteve (-0,5 %) për qind në IHÇK, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0,1 %) në IHÇK. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,4 % në muajin

nëntor 2025, krahasuar me muajin tetor 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (5,1 %); qumësht, djathë dhe vezë (4,2 %); perime (3 %); energji elektrike (1,8 %); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (1,6 %); mish (1,1 %); kujdes personal (1 %); kafe, çaj dhe kakao (1 %); dhe blerje e automjeteve (0,6 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,6 për qind në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: bileta të fluturimeve (-15,9 %) dhe pushime të organizuara (-8,2 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,2 për qind në IHÇK.

Projekti "Solar4Kosovo I (100 MW)" hyn në fazën e parë të tenderimit

Prishtinë, 11 dhjetor - Përfaqësues të KEK-ut kanë mirëpritur një delegacion të lartë nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë (BMZ), Ambasada Gjermane dhe KfW, të cilët zhvilluan një vizitë zyrtare në lokacionin e parkut solar të projektit strategjik "Solar4Kosovo I - Photovoltaics (100 MW)". Delegacioni u mirëprit nga drejtori ekzekutiv i Divizionit

për Energji të Ripërtëritshme në KEK sh. a., Erdoan Zasella, i cili, së bashku me bashkëpunëtorët e menaxhmentit, njoftoi delegacionin me operimet, sfidat dhe objektivat strategjike të Korporatës - me theks të veçantë në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe zhvillimin e parkut solar 100 MW, një ndër projektet më të mëdha të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Vizita u kryesua nga Micong

Klimes, e sapoemëruar zyrtare përgjegjëse për Kosovën në BMZ, e cila përfshiu këtë projekt në itinerarin e saj të parë zyrtar në vend. Prania e saj dhe e partnerëve gjermanë nënvizon nivelin e lartë të mbështetjes politike, financiare dhe teknike që i jepet këtij projekti. Projekti "Solar4Kosovo I (100 MW)", i financuar nga Bashkimi Evropian (WBIF), Qeveria Gjermane përmes KfW dhe bashkëfinancuar nga Banka

Evropiane e Investimeve (EIB), ka hyrë zyrtarisht në fazën e parë të tenderimit - procesin e përzgjedhjes fillestare (parakualifikimit) për dizajnimin, furnizimin dhe instalimin e impiantit. KEK sh.a., së bashku me të gjithë aktorët dhe partnerët që po e bëjnë të mundur këtë projekt, nxisin fuqishëm të gjitha kompanitë e kualifikuara, vendore dhe ndërkombëtare, që plotësojnë kriteret të aplikojnë



në këtë proces të rëndësishëm, i cili do të zhvillohet me konkurrueshmëri të lartë, transparencë të plotë dhe cilësi të garantuar sipas standardeve evropiane.

AVIONË PËR LUFTË ELEKTRONIKE DHE ÇISTERNA E SEKUESTRUAR: “SINJALE” TË REJA PËR KARAKASIN



Mbërritja e një skuadriljeje avionësh amerikanë të luftës elektronike në Karaibe rrit presionin mbi Karakasin dhe ushqen dyshimet mbi qëllimet e vërteta të pajisjes së fuqishme ushtarake të dislokuar në rajon. Sekuestrohet një cisternë venezueliane

Një skuadrilje avionësh të luftës elektronike Ea-18 “Growler” të Marinës amerikane është parë në pistën e Roosevelt Roads, baza ushtarake e Porto Rikos që Shtetet e Bashkuara e kanë bërë sërish operative për të zhvilluar më lehtësisht një “konflikt të armatosur jo ndërkombëtar”, kundër kartelevë të drogës që veprojnë në Detin e Karaibeve, ku Pentagoni vazhdon të grumbullojë një forcë ushtarake gjithnjë e më të madhe dhe të larmishme. Një task force që po merr gjithnjë e më shumë formën e një force pushtuese.

Sipas analistëve OSINT, mund të bëhet fjalë për skuadronin e luftës elektronike të quajtur “Scorpion”, i mbërritur mbrëmë nga baza Whidbey Island në shtetin e Uashingtonit, në Bregun Perëndimor, shumë larg Karaibeve. Ndërkohë, sipas

raportimeve të fundit, administrata Trump sapo ka urdhëruar “sekuestrimin e një cisterne naftë” nga Roja Bregdetare amerikane pranë brigjeve të Venezuelës. Megjithëse ka “rritur presionet mbi presidentin venezuelian Nicolás Maduro”, shkruan Reuters, “Uashingtoni nuk kishte ndërhyrë deri tani për të penguar flukset e naftës”. Ky sekuestrim ndodh në një kontekst tashmë tepër të tensionuar, për shkak të presionit masiv ushtarak të SHBA-së në rajon dhe fluturimeve të çuditshme të avionëve ushtarakë të regjistruar ditët e fundit.

Fluturime të pazakonta në qiellin e Karaibeve

Pas disa fluturimeve zbulimi nga avionët F/A-18 Super Hornet të mbërritur pranë

Maracaibo-s, qyteti i dytë më i madh i Venezuelës, dhe identifikimit në hapësirën ajrore të Gjirit të Meksikës të një tjetër avioni të luftës elektronike të dislokuar në aeroplanmbajtësen USS Gerald Ford, e cila ndodhet aktualisht në Karaibe, prania e këtij skuadroni të veçantë sulmues të luftës elektronike, duke marrë parasysh rolin që do të luante në një operacion të gjerë ushtarak, mund të konsiderohet si sinjali më i fundit për Nicolás Maduro-n, më shumë se për kartelet e drogës.

Ekspertët vazhdojnë të ngrejne dyshime mbi ligjshmërinë e sulmeve të kryera nga amerikanët, të cilët kanë goditur mbi 15 mjete lundruese të paidentifikuara, duke shkaktuar 80 të vdekur. Ndërkohë qeveria e Karakasit i akuzon Shtetet e Bashkuara se po zhvillojnë një “fushatë destabilizimi” kundër Venezuelës, duke u fshehur pas një operacioni të gjerë antidrogë në rajon. SHBA-të kanë dislokuar në Karaibe më shumë se një duzinë anijesh luftarake, përfshirë njësi për operacione amfibie, dy nëndetëse sulmuese, një anije të

inteligjencës dhe të gjithë grupin goditës të aeroplanmbajtëses Ford. Sipas marshallit britanik në pension G. Bagwell, i konsultuar nga BBC, qëllimi i këtyre “fluturimeve të çuditshme” amerikane mund të jetë “testimi i mbrojtjeve venezueliane dhe vëzhgimi i reagimeve si trafiku radio dhe sinjalet e koduara të lidhura me sistemet e mbrojtjes”. Diçka e ngjashme me atë që rusët bëjnë përgjatë kufijve lindorë të NATO-s. Fluturime që konsiderohen të zakonshme.


Misioni i Growler-ve

Growler-at mund të kenë kapur sinjale inteligjence, ndërsa Super Hornet-et mund të kenë ofruar mbulim të mbrojtjes ajrore për “old crows”, “korbat e vjetër”, siç quhen operatorët e luftës elektronike, të specializuar në prishjen e radarëve armikë. Avionët EA-18 Growler përdoren rregullisht në operacione që synojnë dominimin dhe ndërhyrjen në spektrin elektromagnetik, duke penguar emetimet e radio të mbrojtjes ajrore apo tokësore, me synimin që të

mos lejojnë radarët të zbulojnë formacionet mike që përgatiten për një “strike”, pra një sulm bombardues. Kjo arrihet përmes sistemeve të vendosura në podet nën krahë dhe me përdorimin e raketave antiradar, duke shkatërruar rrjetin mbrojtës armik. Lufta elektronike synon të sigurojë përparësi taktike dhe strategjike në përdorimin e spektrit elektromagnetik, “duke u hapur rrugën” avionëve të tjerë luftarakë dhe sulmues.

Sipas oficerit britanik, prania e një Growler-i në fluturim mbi Gjirin e Venezuelës ditët e fundit mund të interpretohet si “mbledhje paraprake informacioni për operacione të mëvonshme, ose thjesht si një paralajmërim për këto operacione”.

Në luftën moderne, ku nga “sinjalet” që përshkojnë spektrin elektromagnetik varet suksesi i çdo operacioni ushtarak kompleks, prania e një skuadroni avionësh për luftë elektronike EA-18 “Growler” mund të nënkuptojë vetëm një gjë: jemi gati t’ju verbojmë radarët dhe t’ju çaktivizojmë sistemet e mbrojtjes, për të goditur nëse do të jetë e nevojshme. / bota.al



Kosova U17 (vajzat) në grup shumë të fortë në kualifikimet për Evropianin 2026

Nion, 11 dhjetor - Në selinë e UEFA-s në Nion është hedhur shorti për raundin e dytë të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2026 për vajzat U17. Kombëtarja e Kosovës është përfshirë në Grupin 6 të Ligës A, ku do të ketë përballje shumë sfiduese, pasi në të njëjtin grup gjenden Spanja, Portugalia dhe Hungaria. Mini-

turneu kualifikues i këtij grupi do të zhvillohet në pranverë në Portugali. Liga A përbëhet nga shtatë grupe me nga katër kombëtare secili dhe përcakton ekipet që do t'i bashkohen Irlandës së Veriut, si vend organizator, në Kampionatin Evropian që do të mbahet nga 4 deri më 17 maj 2026. Sipas rregullores së garës,

fitueset e shtatë grupeve sigurojnë kualifikimin në turneun final, ndërsa skuadra e renditur e fundit në secilin grup bie në Ligën B për edicionin e ardhshëm kualifikues. Ky cikël vlen edhe si fazë kualifikuese të UEFA-s për Kampionatin Botëror U-17 për femra 2026, që do të zhvillohet në Marok.

2025/26 UEFA WOMEN'S UNDER-17 CHAMPIONSHIP ROUND 2 - LEAGUE A			
GROUP A1 DENMARK GERMANY REPUBLIC OF IRELAND SWEDEN	GROUP A2 ENGLAND ITALY CROATIA TÜRKIYE	GROUP A3 FINLAND CZECHIA ROMANIA LATVIA	GROUP A4 FRANCE AUSTRIA SERBIA ICELAND
GROUP A5 SWITZERLAND NORWAY SCOTLAND GREECE	GROUP A6 SPAIN PORTUGAL HUNGARY KOSOVO	GROUP A7 NETHERLANDS POLAND SLOVAKIA WALES	

FFK-ja SHPALL MË TË MIRËT E FUTBOLLIT MË 21 DHJETOR

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Nën drejtimin e presidentit Agim Ademi të enjten është mbajtur mbledhja e radhës e Komitetit Ekzekutiv (KE) të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në të cilën janë diskutuar një sërë çështjesh me rëndësi për mbarëvajtjen e futbollit të Kosovës.

Fillimisht Komiteti Ekzekutiv i FFK-së ka shqyrtuar rrjedhën e garave të këtij edicioni. Është vlerësuar se të gjitha ligat, përveç Albi Mall Superligës, tashmë kanë përmbyllur me sukses stinorin vjeshtor dhe se kampionatet kanë pasur zhvillim të rregullt. “Në elitë kanë mbetur edhe dy xhiro deri në mbylljen e stinorit vjeshtor, për të cilat u shpreh besimi se do të zhvillohen me lojra interesante



dhe korrektësi sikur pjesa tjetër e garave. KE-ia u ka uruar suksese dhe pushim të këndshëm të gjitha klubeve në prag të përfundimit të këtij viti, duke u shprehur mirënjohje për punën në rritjen e nivelit të futbollit në

vendin tonë”, ka njoftuar FFK-ja. Sipas njoftimit të FFK-së, është vendosur që ceremonia tradicionale “Laureatët 2025” të mbahet më 21 dhjetor në hotel “Emerald”, me fillim nga ora 17:00. “Komisioni për Laureatët

tashmë është në finalizim të punëve rreth organizimit të kësaj ngjarjeje të rëndësishme, ku pjesëmarrës do të jetë komuniteti i futbollit dhe mysafirë të shumtë. Gjithashtu, KE-ja ka aprovuar edhe buxhetin për vitin 2026, ndërsa u diskutua edhe për ekipet kombëtare në të gjitha nivelet. Theksi i veçantë u vendos te Kombëtarja A dhe Kombëtarja U21, të cilat po zhvillojnë paraqitje shumë të mira dhe mbajnë ende gjallë shpresat për arritje të sukseseve historike”, ka njoftuar FFK-ja.

Më tutje është bërë me dije se Komiteti Ekzekutiv ka shqyrtuar dhe aprovuar edhe kërkesa e ankesa të ndryshme si dhe një sërë rregulloresh të reja për vitin 2026, përfshirë rregulloret e

administratës së brendshme të FFK-së. Po ashtu, u bë edhe analiza e ekipeve dhe shtabeve teknike të kategorive të reja. “Një nga vendimet e rëndësishme të kësaj mbledhjeje ishte miratimi i marrëveshjes me FIFA-n për hapjen e Akademisë së Futbollit në Hajvali, e para e këtij lloji në Ballkan, e dedikuar për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve më të spikatura. Akademia do të përfshijë 20 vajza dhe 20 djem të grupmoshës 14-16 vjeç, ndërsa nga FIFA është caktuar edhe udhëheqësi i saj, Rainer Andreas Kraft, i cili do të punojë së bashku me Besim Ademin. Akademia do ta ketë edhe stafin përcjellës dhe stafin mjekësor për funksionim sa më profesional”, ka njoftuar FFK-ja.

XABI ALONSO NUK SHKARKOHET TANI, PAVARËSISHT KRIZËS - REAL MADRIDI I QËNDRON BESNIK PROJEKTIT TË TIJ

MADRID, 11 DHJETOR - Real Madridi ka vendosur t'i japë Xabi Alonsos edhe pak kohë, edhe pse ka humbur 2-1 në shtëpi ndaj Manchester Cityt në Ligën e Kampionëve. Kjo humbje e fundit e ka lënë skuadrën vetëm me dy fitore në tetë ndeshje e fundit dhe ka shtuar zërat për një shkarkim të mundshëm. Sipas “Marca”-s, klubi nuk ka ndër mend të marrë masa të menjëhershme dhe dëshiron t'i lejojë Alonsos ta përmbyjë situatën. Madridi e ka nisur

mirë ndeshjen me golin e Rodrygos, por City e ka përmbytur rezultatin me golat e Nico O'Reilly dhe Erling Haaland. Në pjesën e dytë vendasit janë përpjekur ta gjenin barazimin, por pa sukses, ndërsa tifozët kanë shprehur zhgënjim për formën e ekipit. Kjo ishte ndeshja e dytë radhazi në “Bernabeu”, ku Real Madridi është pritur me fishkëllima pas humbjes së papritur në fundjavë me Celta Vigon. Pas ndeshjes disa lojtarë të Real



Madridit kanë treguar mbështetje të hapur për teknikun. Jude Bellingham është shprehur se është në mbështetje të Alonsos. “100 %. Trajneri ka qenë i shkëlqyer. Askush këtu nuk po dorëzohet, të gjithë po luftojmë”, ka thënë Bellingham. Ai ka pranuar se skuadra po përpiqet t'i gjejë shkaqet e krizës, duke thënë se në çastet vendimtare po pësojnë gola që i fusin në vështirësi.

Alonso vetë ka kërkuar qetësi

dhe besim. Ai ka thënë se skuadra ka dhënë gjithçka dhe ka theksuar se periudha e keqe do të kalojë. “Ishte një ndeshje e fortë. Ne punuam deri në fund. Duhet të vazhdojmë të besojmë”, ka thënë trajneri spanjoll.

Për momentin Real Madridi ka vendosur të mos ndërmarrë veprime drastike, por presioni mbi Alonsos mbetet i lartë, pasi klubi ndodhet vetëm në vendin e shtatë në tabelën e Ligës së Kampionëve dhe rrezikon fazat eliminatorë.

Kapiteni Xhaka kërkon fitore ndaj Newcastlelet

Sunderland, 11 dhjetor - Granit Xhaka është maksimalisht i motivuar para ndeshjes së Sunderlandit kundër Newcastle Unitedit, të cilën kapiteni e ka vlerësuar tejet të rëndësishme. Madje Xhaka ka thënë se është duke motivuar edhe

bashkëlojtarët, duke bërë me dije se Sunderlandi është i vendosur për ta mposhtur Newcastle.

Ndeshja Sunderland - Newcastle luhet të dielën prej orës 15:00 dhe i takon xhiros së 16-t të Premierë Ligës angleze. “Kam pasur shumë

kundërshtarë gjatë karrierës sime, por mendoj se Newcastle do të jetë më i madhi. Duhet të mos dorëzohemi dhe t'u japim tifozëve diçka madhështore. Pra, ne si ekip e kemi një synim dhe ai është ta fitojmë ndeshjen”, ka deklaruar

Xhaka. Sunderlandi kërkon që me fitore ndaj Newcastle Unitedit ta kompensojë humbjen e vikendit të shkuar nga Manchester City 3:0. Aktualisht, Sunderlandi ka 23 pikë të mbledhura, një më shumë se Newcastle Unitedi.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Galeria Studio” Sh. P. K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 811882390 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Galeria Studio" D. O. O. od Ljiljan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811882390 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Galeria Studio” L. L. C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 811882390 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lajde Kolgjera shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "At Shtjefën Gjeçovi" Zym Prizren.

- Meriton Deda shpall të palefshme certifikatën e biznesit Lounge Bar “Le Corbusier” Sh.P.K. me nr. 8101275.

- Besim Veseli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".

- Zenun Bajrami B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 810349812.

- Kamer Hajdari shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greicevci”.

- Ajetullah Xhemajli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme Skenderaj.

- Ylbr Peci shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Blerta Hoxha shpall te pavlefshme diplomën e SH.M.L.M. "Dr. Xheladin Deda".

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjumnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.


- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër
prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej:
60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sal-
lon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet.
Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për
afate të gjata dhe të shkurtra.
Informata në tel: 049\44-888-801



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

